

Buletini Informativ Maj 2013



Shoqata e Grave Profesioniste Afariste dhe Zejtare



9. GRATE NE BIZNES

BIZNESALBANIA konstaton se gratë sipërmarrëse, sidomos në rrethe ndjejnë mjaft presionin e taksambledhësve dhe klimën jo mbështetëse të institucioneve lokale. Shoqatat e grave theksojnë se mungon fryma e bashkëpunimit në rrethe sidomos në çështjen gjinore, ku thirren për konsulta, të cilat edhe këto janë të rralla, vetëm sipërmarrësit dhe jo sipërmarrëset.

Bizneset e vogla të drejtuara nga gratë po diskriminohen, edhe pse mbajnë peshën më të rëndë ekonomike ku 30% përfaqësohen prej tyre.

Në bazë të 10 parimeve të Aktit të Biznesit kërkojmë për sipërmarrëset gra:

- Kreditime te ulta,
- përfshirje në projekte të BE-së,
- markën e tyre si biznes,
- standartizimin e produkteve artizanale me parametrat evropiane,
- kualifikimin profesional të grave në biznes duke mbuluar të paktën 50% të kostove të kualifikimit.

Aktivitetet Maj 2013

Data	Vendi	Aktiviteti	Pjesemarrja
2	Tirane	Takim me berthamen e parukiereve	10
3	Durres	Mbledhja e zhgjeruar e SHGPAZ	20
6	Tirane	Takim e me Atasheun Turk	2
9	Tirane	Takim me berthamen e Mobilereve	10
	Tirane	Takim me perfaqesues te GIZ	3
13	Tirane	Takim me berthamen e Artizanatit	10
14	Tirane	Forum me bizneset Belqe	4
15	Tirane	Forum me bizneset Meksikane	1
15-17	Sofje	Mbledhja e Bordit te MBB	3
16-20	Mexhugorje	Takimi i AIC	4
18-21	Lamie	Ekspozita nderkombetare ne Greqi - Lamie	8
22	Tirane	Forumi I biznesit Maqedoni – Shqiperi	20
23-25	Moldavi	Zhvillimi i turizmit me barazine gjinore	1
27	Tirane	Takim me berthamene e Hoteliereve	10
	Tirane	Takim me berthamen e Mobiljereve	10
	Tirane	Takim me rrjetin e eksperteve	10
28-31	Sofje	Ndermarrja mike e familjes nga MBB	3

Numri i pjesemarrsesve - 129


Numri i aktiviteve organizuara nga SHGPAZ – 9

Numri i aktiviteve te organizuara nga te tjeret - 8

Takim me berthamen e parukiereve



Mbledhja e bordit, Durres 2013



Takim me berthamen e mobilieve



Takimi i berthames se artizaneve-projekti EDEP




Forumi i bizneseve Maqedonase dhe Shqiptare



Mbledhja e bordit te MBB, ne Sofje



Forum ekonomik me Dhomen greke te tregtise, Lamia—Greqi



Takimi ne Mexhugorje , dhenia e cmimit per SHGPAZ



Takimi ne Moldavi



Meritat e vërteta të stilolapsit dhe letrës në biznes!

Personalisht, jam shumë i dhënë ndaj teknologjisë dhe mbetem entuziast për gjithçka që të lejon të bësh! Por, në të njëjtën kohë, më duhet të pranoj pengesat apo mënyrat se si teknologjia më kufizon që të bëj atë që duhet të bëj më mirë – konkretisht; të organizoj mendimet apo të planifikoj punën time! Prandaj, e them me bindje të plotë se, deri tani, nuk kam gjetur asnjë teknologji më të mirë se sa një stilolaps me një bllok shënimesh që të më ndihmojnë gjatë procesit të planifikimit apo organizimit të punës së përditëshme.

Gjithashtu, kam kuptuar që kjo dukuri është shumë e përhapur! Mund të them me garanci se e kam dëshmuar shumë herë këtë fakt te mjaft menaxherë, CEO apo njerëz të tjerë të cilët çdokush do t'i konsideronte të suksesshëm në atë që bëjnë. Pavarësisht përmirësimit të vazhdueshëm të teknologjive për biznesin, ata vazhdojnë të përdorin stilolapsin dhe letrën/bllokun për të mbajtur shënime si dhe për të organizuar mendimet apo punën e tyre të përditëshme. Më pas këto shënime mund të kalohen në celular apo në kompjuter, por për ta, procesi kreativ apo organizativ mendor kryhet më mirë me një stilolaps dhe letër!

Avantazhi kryesor i përdorimit të stilolapsit dhe letrës është pikërisht mundësia për t'u fokusuar apo për t'u përqëndruar plotësisht në atë që duhet të bëni pa u shpëputur vëmendja nga teknologjitë e tjera (si p.sh. kompjuteri, celulari, etj) apo edhe vetë njerëzit që kenë përreth. Ndonëse shumëkush është joshur nga ideja dhe i mban bindjen se mund të bëjë shumë gjëra njëherësh (ajo që ndryshe quhet '*multitasking*'), fakti mbetet, dhe studimet e kanë provuar, që ne i bëjmë gjërat më mirë kur i bëjmë një-nga-një. Sidomos, për sa i përket diskutimit në fjalë – procesit kreativ, planifikimit të punës apo organizimit të ideve. Ky proces kryhet më mirë kur ne i japim përqëndrim dhe vëmendje të plotë. Kjo është e vetmja arsye pse mbetem mbështetës i fortë i përdorimit të kësaj teknologjie 'të lashtë' siç është stilolapsi dhe letra!

Në çdo rast duhet të pranojmë se teknologjia më e mirë është ajo që na lejon të bëjmë më mirë punën tonë por njëherazi duhet të jemi të kujdesshëm kur ajo mund të na kufizojë të bëjmë gjëra bazë siç është procesi i të menduarit! Për disa prej nesh, stilolapsi dhe letra janë brenda kompjuterit apo tablet-it që mbajnë gjithë kohës me vete, ndërsa për të tjerë mbetet blloku i shënimeve apo copa letrash që i mbajmë gjithnjë me vete. Në fund të ditës, jeni ju vetë që duhet të analizoni dhe kuptoni se cila është teknologjia apo mjetet që ju lejojnë të bëni më mirë atë që quhet planifikimi apo organizimi i punës tuaj.

Pse duhet të keni një profil profesional në LinkedIn

Ndonëse numri i anëtarëve në Facebook ka kaluar kuotën e 850 milionëve, LinkedIn mbetet rrjeti kryesor ku ju si profesionist apo si kompani duhet të jeni të pranishëm qoftë thjesht për efekt serioziteti!

Thënë ndryshe, nëse e konsideroni veten seriozisht si profesionist apo kompaninë tuaj si një kompani serioze, atëherë emri juaj në LinkedIn do t'ji shtojë më tepër vlera profilit tuaj profesional. Kjo vlen edhe për studentët të cilët janë ende në fillesat e karrierës së tyre profesionale.

Shumica e personave me të cilët bisedoj, qoftë edhe ata të cilëve u ofroj konsulencë, nuk e kuptojnë gjithnjë vlerën e LinkedIn dhe rëndësinë e krijimit apo mirëmbajtjes së profilit të tyre në këtë rrjet social për profesionistët. Me rreth 135 milion profesionistë të regjistruar dhe mbi 2 milion kompani nga e gjithë bota, LinkedIn është plotësisht i përkushtuar si shërbim dhe si rrjet drejt nevojave të profesionistëve. Numri i profesionistëve shqipfolës në LinkedIn vjen gjithnjë e në rritje dhe mund të them që mbi 80% e kontakteve të mia në këtë rrjet janë shqiptarë.

Kur dhe pse biznesi juaj duhet të ketë një blog ?

Bizneset shqiptare po e kuptojnë me rritme të shpejta nevojën e një pranie online. Madje gjithnjë e më shumë po shohim faqe interneti që reklamohen nëpër broshura, postera apo edhe kartvizitat e biznesmenëve shqiptarë. Dhe kjo është shumë pozitive. Por fatkeqësisht, për shumicën e faqeve në fjalë, kjo është pothuajse gjithçka që ndodh. Shumica e bizneseve shqiptare (dhe botërore) që kanë marrë mundimin të krijojnë një faqe në internet për prezantimin e kompanisë së tyre, rrallë herë mendojnë ose mundohen që t'ji përditësojnë ato. Shumica e faqeve të bizneseve, qofshin këto edhe nga ato të nivelit korporativ, nuk përditësohen shumë dhe informacioni në to duket sikur e ka zënë myku sa herë që kupton që data e publikimit është bërë tashmë disa vjeçare!

Ljubinka Veshovic*

Flutura zbarkoi në flokët e saj,
mendoj të jete lule,
dhe ben pak pushim mbi të
ti marre erë e te ndal fluturimin
dhe floket e saj, e te sajat floke
te verdha si gruri i artë.
dhe floket e saj, e te sajat floke
shndritin e shkelqejne si diell.

Ljubinka Veshovic

Лептир је слетио на њену косу:
мислио да је цвијет.
и ту је застао да удахне
мирис који му скрати лет.

а њена коса, а коса њена
жута као златно класје.
а њена коса, а коса њена
блиста и на сунцу сја се

*Ljuba, nje mikja ime malazeze, artizane dhe grua ne biznes...gjen
kohe edhe per poezi, edhe pse i ka kaluar te 50-tat.Eshe grua e qete,
e edukuar dhe mjaft e dashur me te gjithë*

*

Kuriozitet

Cfare eshte e-banking?

Me zhvillimin e internetit dite pas dite dhe me permiroresimin e aftesise se tij per te permbushur nevojat dhe kerkesat e njerezve, edhe ne sektorin bankar ka pasur progres ne kete fushe. Bankat ne te gjitha boten dhe pjesa me e madhe e bankave ne Shqiperi gjithashtu, ofrojne tashme nje sherbim online, te quajtur e-banking. E-banking i lejon klientet te kryejne nje sere transaksionesh online, pa qene nevoja te shkojne deri ne banke. Qellimi kryesor: t'i bejne gjerat me te lehta per klientet! Gjithcka behet duke hyre ne sitin web te ofruar nga banka juaj dhe duke ndjekur hapat e duhura per te kryer operacionin qe doni. Siguria ofrohet nepermjet sistemeve te sigurimit, por duhet te tregoni gjithmone kujdes. Ka nje rang te gjere sherbimesh te ofruara dhe disa banka do t'ju japin kushte me te favorshme, nese zgjidhni te kryeni transaksione online.

Perse me nevojitet?

Te kursen shume kohe! Per shume nga transakcionet qe ju duhet te kryenit me pare (si pagesa, transferta etj), ju duhej te gjenit kohe per te shkuar ne banke. Shume mundesisht do t'ju duhej edhe te prisnit ne radhe. Dhe ka gjithmone kufizime ne kohe: bankat mbyllen ne nje orar te caktuar dhe nuk jane hapur as ne fundjave dhe gjate festave. Me e-banking, keto kufizime nuk ekzistojne me: ju mund te hyni ne llogarine tuaj online ne cdo ore te dites, cdo dite te javes. Ju mund te qendroni ne shtepi ose ne zyre dhe gjithsesi, t'i beni te gjitha ato qe kishin ndermend. Ju mund edhe te kontrolloni shumen ne llogarine tuaj, si dhe nje historik te te gjitha transaksioneve tuaja, kur te deshironi. Ne kete menyre, do ta dini gjithnje poziten tuaj financiare, dhe nuk do te lodheni per ta marre kete informacion!

Komunikimi dhe respekti ne biznes

Një nga aspektet aq shpesh të neglizhuara është komunikimi me respekt, mund të themi thjesht komunikimi, por veçanërisht në kulturën shqiptare të biznesit duhet theksuar edhe respekti në komunikim pasi përplasjet apo diferencat ndërmjet shtresave kulturore, intelektit apo edhe bindjeve morale i bëjnë njerëzit që të diskriminojnë në sjelljen dhe njëherazi në komunikimin e tyre. Ka një mori modelesh komunikimi por aktualisht dua të prek shumë shkurt dy prej tyre.

Komunikimi brenda biznesit

Përsa i përket komunikimit brenda biznesit, d.m.th ndërmjet kolegëve apo eprorëve dhe nënpunësve, duhet mbajtur gjithnjë një komunikim i hapur ku mund të diskutohen dhe debatohen idetë, sugjerimet, komentet apo edhe ndryshimet e mendimeve të njëjës palë me tjetrën.

Ky lloj komunikimi ku respektohen mendimet dhe idetë e tjetrit, ku pranohen edhe idetë e kundërta, jo thjesht si urdhëra për t'u bindur por minimalisht për t'u konsideruar, ndihmon në krijimin e kushteve ku mbështetet zhvillimi i mëtejshëm i biznesit, i risive, i shërbimit dhe produkteve që ofron ky biznes.

Komunikimi me klientët

Sërish, mungesa e respektit në komunikimin me klientin është një situatë e vështirë në të cilën gjendet biznesi shqiptar. Arsyet janë nga më të ndryshmet, por kryesisht janë për arsye përzierje shtresash të ndryshme sociale dhe kulturore brenda vendit të cilat domosdo çojnë edhe në keqkuptime dhe mungesë respekti për tjetrin, ku në rastin tonë i bie të jetë klienti!

Koncepti perëndimor i marrëdhënies dhe trajtimit të klientit përmbledhet shumë qartazi nga shprehja “klienti është mbret” dhe ashtu duhet të jetë realisht edhe në ambientet e biznesit shqiptar ku klienti duhet vënë i pari mbi preferencat apo bindjet zakonore të atij që e ka biznesin (pronarit). Gjithësesi, duhet të pranojmë që çdo gjë kërkon kohën e vetë dhe brumosja e vlerave të mirëfillta të respektit ndaj klientit, dhe veçanërisht komunikimit me respekt për klientin, i duhet koha e vet.



**Redaktim&pergatijte perfundimtare
msc.Flutura XHABIJA**

**Mblodhi materialet & draftoi
jur.Marjeta MAZNIKU
ndihmoi Silvana Barci**

**Ndihmuan me verejtje shume
bashkepunetore te jashtem**